



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 8 prill 2013

Nr. i lëndës. 2012-13

Bejtush Gashi

Kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 8 prill 2013, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së sipërpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit, e cila së fundi ka pësuar ndryshime më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 23 tetor 2012.

II. FAKTET

2. Ankuesi dhe gruaja e tij E.G. kishin tre fëmijë, të lindur, respektivisht, në vitin 1993, 1995 dhe 2000.
3. Më 12 prill 2002, Gjykata e Qarkut në Prishtinë shpërbën martesën e ankuesit. Në gjykimin e shkurorëzimit gjykata i ka dhënë kujdestarinë e plotë të tre fëmijëve parashtruesit të ankesës.
4. Më 8 tetor 2009, Gjykata Komunale e Prishtinës i jep kujdestarinë e fëmijëve ish-bashkëshortes së ankuesit dhe urdhëron atë të paguajë për mirëmbajtjen fëmijëve. Për më tepër, me kërkesën e E.G., gjykata lëshoi një urdhër për mbrojtje duke ndaluar ankuesin për të ngacmuar, shqetësuar apo kontaktuar atë apo fëmijët.
5. Më 16 dhjetor 2009, Gjykata e Qarkut në Prishtinë hodhi poshtë ankesën e ankuesit kundër këtij vendimi.
6. Ankuesi u mbajt në paraburgim më 29 korrik 2010. Më 12 prill 2012, ai u gjet fajtor për dy vrasje, një vrasje në tentativë, të gjitha shkeljet e kryera në korrik të vitit 2010 dhe ai u gjet gjithashtu fajtor për posedim të paligjshëm dhe përdorimin e armëve të zjarrit. Ai u dënuat me tridhjetë e tre vjet burgim. Duket se një prej viktimateve të vrasjeve ishte ish gruaja e tij, E.G. Nuk është e qartë se kush e ka pasur kujdestarinë mbi fëmijët e ankuesit që nga vdekja e E.G. dhe arrestimi i tij i mëvonshëm.

III. ANKESAT

7. Ankuesi paraqet në terma të paqarta se kujdestaria e tre fëmijëve të tij i ishte dhënë padrejtësisht ish-gruas së tij dhe se fëmijët ishin "të nxitur kundër tij" nga E.G., nga avokatët e saj dhe punonjësit socialë. Ai nuk thirret në ndonjë nga dispozitat e instrumenteve ndërkombëtare përmes mënyrave të drejtave të njeriut.

IV. LIGJI

8. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendosë nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregullën 29 të Rregullores së vet të Punës.
9. Në pajtim me Rregullën 25, paragrafi 3 të Rregullores së Punës, ankesa duhet të dorëzohet brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së pretenduar.
10. Paneli vëren se shqetësimet e ankuesit kanë të bëjnë, në thelb, me rezultatin e divorcit dhe procedure e paraburgimit. Vendimi përfundimtar në këto procedura është dhënë më 16 dhjetor 2009, kur Gjykata e Qarkut në Prishtinë e hodhi poshtë ankesën e ankuesit kundër aktgjykit të shkallës së parë. Ankuesi paraqiti ankesën e tij

në Panel më 23 tetor të vitit 2012. Megjithatë, në pajtim me rregullën 25, paragrafi 3 të Rregullores së Punës ankesa duhet të jetë paraqitur brenda gjashtë muajve nga vendimi duke argumentuar shkeljen e pretenduar, më së largu më 16 maj 2010. Prandaj ankesa nuk plotësonë kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregullën 29 të Rregullores së Punës së Panelit.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konsideron se ai nuk ka kompetenca ta shqyrtojë ankesën dhe konstaton që ankesa është dukshëm e pabazuar sipas nenit 29 (d) të rregullores së vet të punës, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese e Panelit